



KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		06/10/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	060/04-	44	110

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas



P R O C E S V E R B A L
I
DËGJIMEVE BUXHETORE

Vendi: SHFMU “Rilindja”, Drobroshec

Datë: 18.08.2025

Ora: 17:30

Dëgjimet buxhetore në Dobroshec u mbajtën më 18 gusht 2025, ku morën pjesë përfaqësues nga fshatrat Dobroshec, Godanc, Gllanasellë, Likoshan, Çikatovë e Vjetër dhe Gradicë. Në këtë dëgjim buxhetor, nga Komuna ishin të pranishëm:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
Muhamet Gjoka	Drejtore i Drejtorisë për Arsim,
Endrit Gllareva	Drejtore i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Nexhmedin Gruda	Drejtore i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, dhe UD i Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kushtrim Bajraktari	ZKF-Zyrtar Kryesor Financiar
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Rendi i ditës

Dëgjimi Buxhetor filloi me këtë rend dite:

1. Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028,
2. Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave,
3. Çështje të ndryshme.

Hyrje

Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028

Hapjen e dëgjimit buxhetor e bëri **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra**. Në fjalën e tij hyrëse, ai theksoi rëndësinë e organizimit të dëgjimeve buxhetore si mekanizëm i transparencës dhe i përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor. Po ashtu, ai prezantoi rregullat dhe procedurat që do të ndiqeshin gjatë zhvillimit të këtij dëgjimi.

Tutje, fjalën e mori **Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen aktive në këtë proces. Ai theksoi se dëgjimi ka për qëllim shpalosjen e projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028, si dhe mbledhjen e kërkesave e propozimeve nga qytetarët për projektet e nevojshme në komunitet.

Kërkesat

Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave

Pas fjalës përshëndetëse të Kryetarit Lladrovci, fjalën e morën përfaqësuesit e fshatrave të këtyre lokaliteteve, të cilët parashtruan kërkesat e tyre.

Përfaqësuesit e fshatrave paraqitën kërkesat e tyre. Në total u parashtruan tri kërkesa kryesore: Ndriçim publik, Infrastrukturë rrugore, Ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat u pranuan dhe u regjistruan, ndërsa u dhanë përgjigje të përgjithshme nga kryetari i komunës dhe drejtorët përkatës.

Përfaqësues / Banor	Lokaliteti	Kërkesa	Përgjigja / Sqarimi nga institucioni
Shabani Berisha	Gllanasellë	Pjesë e urës në rrugën Xhevë Lladrovci. Pjesë të kanalizimeve në lagjen Berisha kanë disa prishje. Te rrethi i urës duhet të vendosen gilindera, pasi aty qarkullojnë nxënës afër shkollës dhe paraqet rrezik.	Kryetari Lladrovci falënderoi qytetarin Shaban Berisha për kërkesat e paraqitura dhe njoftoi se disa prej këtyre projekteve tashmë janë në fazë realizimi. Sa i përket çështjes së kanalizimeve, ai sqaroi se kjo është kompetencë e shërbimeve publike dhe nuk hyn në këtë diskutim, pasi punimet kryhen nga kompania e kontraktuar për këtë qëllim. Ndërsa për zonën tek rrethi i urës, kryetari theksoi se do të angazhohet drejtoria përkatëse për të shqyrtuar mundësinë e intervenimit, formën dhe kapacitetet që ekzistojnë, duke theksuar se kjo është një çështje me rëndësi që do të trajtohet me prioritet.

Qerim Berbatovci	Përfaqësues i fshatit Godanc	Kërkesa: rruga prej mullirit deri në rrugën kryesore të rregullohet me zhavorr. Rrugët anësore brenda fshatit të lidhen dhe të rregullohen. Vazhdimi i rrugës Adem Berbatovci – vetëm asfalti ka mbetur për t'u hedhur. Ndriçimi publik ka mbetur në disa pjesë pa përfunduar.	Kryetari Lladrovci falënderoi përfaqësuesin e fshatit Godanc, Qerim Berbatovcin, dhe e njoftoi se kërkesat e paraqitura do të realizohen, por duhet pritur derisa të vijë radha e tyre. Njëra prej këtyre kërkesave mund të realizohet edhe brenda këtij viti, pasi kontrata për implementimin e projektit të ndriçimit publik tashmë është nënshkruar dhe kompania do të fillojë punimet në terren brenda pak javësh. Edhe projektet e tjera të përmendura do të realizohen gjatë vitit të ardhshëm, pasi janë projekte që mund të përballohen financiarisht dhe nuk kanë kosto të madhe buxhetore.
--------------------------------	-------------------------------------	---	---

Hafiz Muja	Administrator, Gradicë- Likoshan	Kërkesë për DKA (arsimi) – rrethojën e shkollës në Gradicë. Punimet kanë filluar para 2-3 vitesh dhe kanë mbetur në gjysmë. Mbeturinat pranë shkollës nuk janë hequr. Kanalizimi te lagjja Dibrani dhe te lagjja Uka – punimet kanë filluar por operatori nuk ka punuar tash e dy javë. Rruga për tek shtëpia e Lec Gradicës është kërkuar edhe vitin e kaluar. Po ashtu edhe për lagjen Fazliu, Uka dhe Dervishi – rreth 800–900 metra rrugë që lidhen tri lagje. Nevojitet të shtrihen 300 metra rrugë zhavorrore te shtrati i vëllezërve Fazliu.	Kryetari Lladrovci: Këto kërkesa i takojnë një dikasteri tjetër. Rruga Likoshan–Qirez: vitin e kaluar janë sanuar disa gropa, por janë prishur shpejt. Operatorët kanë për obligim t'i rregullojnë përsëri. Do të ndërtohet rrugë e re, por deri atëherë duhet të sanuohen gropat për të mos u bërë të pakalueshme.
		Ujësjiellësi në Likoshan është bërë, por nuk është funksional sepse nuk lëshon ujë. Janë djegur dhjetëra hektarë tokë bujqësore. Rruga Gani Maliqi është e gjatë dhe jo e përfunduar. Aty jetojnë tri familje që i dërgojnë fëmijët në shkollë me vetura.	
Lavdim Berisha	Lagjja Berisha, Gllanasellë	Nuk ka trotuar te lagjja Berisha, gjë që paraqet rrezik për nxënësit.	Kryetari Lladrovci: Komuna nuk ka tokë publike në atë zonë. Për të bërë projektin e trotuarit duhet të blihet toka private, gjë që kërkon buxhet shtesë.

Arsim Avdyli	Drejtor i Shkollës në Dobroshec	Parking për shkollën është emergjent. Rregullimi i kulmit të shkollës është i domosdoshëm – ka rrjedhje gjatë reshjeve. Është tentuar të rregullohet nga punëtorët e shkollës, por pa sukses. Fusha e sportit kërkohet nga prindërit të rregullohet me bar artificial ose ndonjë formë tjetër. Ndërhyrja në këto pika është e domosdoshme	Kryetari Lladrovci: Për këtë kemi ofruar kockat e sheshit. Drejtori ka thënë se është i paraparë si projekt.
Illir Nika	Drejtor i shkollës në Gllanasellë	Izolimi i shkollës është i dobët. Disa dritare janë ende metalike dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente.	Muhamet Gjoka: Kemi aplikuar në fondin për efijencë.
Bujar Tahiri	Banor i Likoshanit	Për shkollën falënderon, pasi çdo kërkesë është realizuar nga Drejtoria e Arsimit. Gjashtë lisat që njihen në fshatin Likoshan të mbrohen që të mos shkatërrohen.	Faleminderit për vlerësimin dhe bashkëpunimin. Drejtorisë së Arsimit i shkon mirënjohja për përkushtimin dhe realizimin e çdo kërkesë të paraqitur nga shkolla. Sa i përket gjashtë lisave që njihen në fshatin Likoshan, komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre si pasuri natyrore dhe simbol i trashëgimisë së fshatit, duke parandaluar çdo dëmtim apo shkatërrim të mundshëm.

Çështje të ndryshme

Nuk pati pika shtesë për diskutim.


Përfundimi

Meqenëse rendi i ditës u përmbyll, dëgjimi buxhetor u shpall i përfunduar.

Kryetari falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

Numri i Pjesëmarrësve		
M - 30	F - 5	Totali: 35

Procesmbajtësi


Avdyl Mziu

